



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.17

Prishtinë, më 09.06.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Srdjan Popović.

Mungoi : Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Dagmar Fuchs Schmitz-GIZ, Sokol Elshani-GIZ, Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015;
3. Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ-it;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ;

Nait Hasani, falënderon GIZ-in për mbështetjen e ofruar dhe tha se agjenda e takimeve për anëtarët e Komisionit është shumë e rëndësishme, për të marr më shumë njohuri rreth fushë se arsimit në Gjermani dhe mënyrës se si bëhet monitorimi i ligjit, kontrollimi i Qeverisë, si merren vendimet dhe si miratohen ligjet.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se kjo është listë e çështjeve organizative dhe pikave për diskutim gjatë vizitës. Ajo theksoi se është mirë që të përcaktoheni se në çfarë do të fokusoheni gjatë vizitës dhe të ndahen përgjegjësitë në mes anëtarëve të Komisionit.

Nait Hasani, tha se ende nuk i kemi precizuar temat mirëpo së shpejti do të bëjmë ndarjen e këtyre përgjegjësiave.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se në mënyrë që ju të mund të përfitoni sa më shumë nga kjo vizitë është shumë me rëndësi që ti ndani përgjegjësit dhe se paku për çdo vizitë të ketë një pyetje specifike, në mënyrë që të merrni edhe përgjigjet specifike por dhe në këtë mënyrë institucionet Gjermane do të kenë një perceptim pozitiv për institucionet e Kosovës. Në vazhdim njoftoi se vizita në Qeverinë Kombëtare është konfirmuar, në Komisionin Parlamentar për Arsimit është konfirmuar, në Komisionin Parlamentar për Financa jemi në pritje, në Këshillin Federal pasi që nuk ka pas interesim të madh është anuluar, në Qeverisjen e Shtetit dhe në Senatin e Berlinit është konfirmuar, në Zyrën Komunale për Arsim është konfirmuar, në Ministrinë e Arsimit është anuluar për shakë të vizitës së ministrit të arsimit atje para pak ditësh, vizita në një shkollë në Berlin është konfirmuar, në Përfaqësimin e Komisionit Evropian është anuluar sepse kanë shumë vizita gjatë kësaj jave dhe në Sindikata gjithashtu është anuluar.

Nait Hasani, pyeti nëse mund ti parashtrojmë pyetjet për Ministrin e Arsimit në Komisionin Parlamentar të Arsimit.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se për monitorim e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm ka mundësi por për rolin dhe funksionin jo. Ajo tha se draftin final do t'ua përcjellim, do ti keni përafërsisht dy takime ne dite, lokacioni i hotelit është në qendër dhe është shumë mirë i lidhur me transportin publik sepse për vizita në Berlin do të përdorim transportin publik në mënyrë që mos ta keni problem vonesën. Në njërën prej mbrëmjeve do ta vizitoni Ambasadën e Kosovës në Berlin dhe do të bëni një shëtitje rreth qytetit me autobus dhe pyeti anëtarët nëse donë të organizojnë një vizitë në një koncert.

Nait Hasani, tha se agjenda nuk është e ngarkuar, ne do ti ndajmë detyrat tona dhe shpresoj që Komisioni të marr një praktik më të mirë në edukimi dhe në fushat që ne jemi të përfshirë sepse arsimi në Kosovë nuk është në nivelin e duhur . Ne si komision do të bëjmë përpjekje të shfrytëzojmë në maksimum këtë vizitë.

Ismajl Kurteshi, tha se ndarja e detyrave do të jetë e natyrshme, opozita do të merret me opozitën konstruktive që është te Qeveria Kombëtare dhe do te përgatis pyetje edhe për monitorimin e Qeverisë nga Komisioni Parlamentar dhe për monitorimin e cilësisë së arsimit dhe vizita në një program artistik duhet të jetë në kulturën gjermane sepse është me rëndësi të njohim diçka edhe nga kultura gjermane. Ai tha se do të shfrytëzojmë këtë vizitë maksimalisht për të fituar përvoja për punën tonë në Komision.

Shpejtëm Bulliqi, tha se kjo vizitë do të jetë e dobishme që ne të marrim përvoja të reja të punës nga Institucionet në Gjermani, që do të na shërbejnë këtu pozitivisht dhe informacione për problemet që ne i kemi në proces.

Shukrije Bytyqi, falënderon për mbështetjen dhe angazhimin. Ajo tha se shpresoj që të kthehem me përvoja të mira këtu.

Srdjan Popović, falënderon për angazhimin në këtë vizitë studimore për të mësuar nga sistemi gjerman. Ai pyeti se a janë duke përgatitur institucionet atje ndonjë lloj prezantimi sepse do të ishte me rëndësi për ne që të definojmë pyetjet tona.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se në Bundestag do të bëjnë një prezantim të përgjithshme por është me rëndësi që ju të bëni pyetje specifike të fokusuara për nevojat e juaja këtu, ata sigurisht do të ju pyesin se si është çështja në Kosovë dhe të paktën një anëtarë i Komisionit duhet të jetë i gatshëm të shpjegoj qartë situatën pra që kjo vizitë të jetë e suksesshme varet nga ju.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani